

# RELACION

## PËR

### PROJEKTLIGJIN “PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Republika e Shqipërisë ka tashmë një sistem azili për të cilin po punohet gjithmonë e më shumë, për t’iu afruar standardeve evropiane, duke realizuar funksionimin e plotë të procedurave në përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Gjenevë, më 28.7.1951, dhe në protokollin “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Nju Jork, më 31.1.1967. Në konventën e OKB-së është aderuar me anë të dekretit të Presidentit të Republikës nr.200, datë 3.6.1992.

Më pas, Shqipëria ka nënshkruar dhe miratuar edhe marrëveshjen, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, nëpërmjet ligjit nr.7833, datë 22.6.1994, të shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës me nr.878, datë 6.7.1994.

Nëpërmjet këtyre akteve, Shqipëria është radhitur në krah të atyre vendeve juridikisht të qytetëruara, duke promovuar dhe përhapur vlerat e njerëzimit dhe duke u bërë pjesë e konventave ndërkombëtare, si për shembull Konventa e Gjenevës së vitit 1951 dhe Protokollin e Nju Jorkut në fushën e azilit, duke krijuar një sistem efektiv të azilit, të fushës të të drejtave dhe të detyrimeve për azilkërkuesit, refugjatët, personat në mbrojtje dhe autoritetet përgjegjëse.

Gjithashtu, neni 80, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë do të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe të protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967, për të siguruar, në këtë mënyrë, respektimin e parimit të moskthimit (*non-refoulement*) të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe të refugjatëve.

Po ashtu, çështjet e trajtimit të azilkërkuesve janë bërë një subjekt gjithnjë edhe më i shpeshtë i trajtimit edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në

zbatim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qenë se kjo Konventë dhe autoriteti i Gjykatës së Strasburgut kanë një vend të veçantë në Kushtetutën dhe të drejtën e brendshme në Shqipëri, ky fakt përbën një shtysë tjetër për rregullimin me të plotë ligjor dhe në përputhje me detyrimet/standardet ndërkombëtare të fushës së azilit në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të plotësimit të kushteve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, megjithëse në vlerësimin përfundimtar të ekspertëve të shteteve anëtare, legjislacioni për azilin u vlerësua pozitivisht, në raportin e vlerësimit dhe në një sërë takimesh të tjera janë dhënë disa rekomandime në interes të përmirësimit të tij. Nga ana tjetër, nga viti 2014 deri në ditët e sotme, organizmat shtetërore që merren me zbatimin e këtij ligji kanë identifikuar disa mangësi dhe paqartësi në interpretim dhe zbatim, të cilat gjejnë zgjidhje të plotë ligjore në projektligjin e paraqitur.

Projektligji synon përputhshmëri të mëtejshme me *acquis* të Bashkimit Evropian në fushën e azilit.

Ndër synimet kryesore të këtij projektligji janë forcimi dhe përmirësimi i mëtejshëm sipas kuadrit ligjor ndërkombëtar të politikave në fushën e azilit dhe që shërbejnë në forcimin e aftësive të shtetit shqiptar për të garantuar zbatimin e angazhimeve e të detyrimeve komunitare të BE-së në funksionimin e të gjithë përbërësve të sistemit të azilit, zbatimi me korrektësi i parimit juridik ndërkombëtar i njohur nga e drejta ndërkombëtare zakonore e moskthimit dhe i të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve nga agjencitë ligjzbatuese, si dhe trajtimi në mënyrë të barabartë me shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në territorin shqiptar.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur agjendën 2030 si pjesë e prioritetëve të veta kombëtare dhe, gjithashtu, ka mirëpritur marrëveshjen globale mbi migracionin dhe objektivat e saj. Vendimi i qeverisë shqiptare për të rinovuar Strategjinë Ndërsektoriale për Migracionin paraqet një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e migracionit.


Ky projektligj hartohet në kuadër të këtij vizioni strategjik dhe përbën një hap të rëndësishëm në përfafrimin e legjislacionit shqiptar me zhvillimet e rëndësishme që ka pësuar legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e azilit.

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave, për vitin 2020, për Ministrinë e Brendshme.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Njësoj si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është prekur nga flukset e përziera migratore, të cilat përbëhen, ndër të tjera, nga refugjatët dhe azilkërkuesit, migrantët, viktimat e trafikimit, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, dhe personat pa shtetësi. Disa prej tyre futen në më shumë se një nga këto kategori. Ata vijnë nga shtetësi të ndryshme, ku shumica janë sirianë, irakenë, algjerianë, pakistanezë dhe afganë dhe shpesh hyjnë në vend pa leje hyrjeje. Në të shumtën e rasteve, këta migrantë janë në një situatë të caktuar vulnerabiliteti për shkak të situatës në vendet e tyre të origjinës prej të cilave janë larguar, për shkak të kushteve të vështira ose shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar përgjatë udhëtimit<sup>1</sup>. Këto flukse kalojnë kryesisht tranzit në Shqipëri përpara se të hyjnë në vendet e Bashkimit Evropian.

**Figura 1. Migrantë të parregullt të kapur në territorin e Shqipërisë (2009-2019)**




Burimi: Profili i Migracionit 2017-2019, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë & UNHCR

Referuar të dhënave të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët kjo rritje është shoqëruar dhe me një rritje të konsiderueshme të numrit të kërkesave për

<sup>1</sup> Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021


azil, duke kulmuar në vitin 2018, ku numri i azilkërkuesve ka qenë 14 herë më i lartë krahasuar me vitin 2017, ku ka pasur në total 309 kërkesa për azil (Fig.2)., dhe rreth 40 herë me i lartë krahasuar me vitin 2015. Ky trend ka vijuar edhe në vitin 2019, ku janë evidentuar 6 604 kërkesa për azil.

**Figura 2. Mbërritjet dhe azili 2015 – 2019**




Burimi: UNHCR (2015-2017 statistika zyrtare nga QSH / 2018-2019 UNHCR & QSH)

**Figura 3. Përqindja e grave dhe fëmijëve 2018**



Burimi: UNHCR (Dashboard 2018)

**Figura 4. Përqindja e grave dhe fëmijëve 2019**



Burimi: UNHCR(Dashboard2019)

Pavarësisht skenarëve të sipërpërmendur, aktorët e përfshirë në ofrimin e ndihmës, të shërbimeve dhe të mbrojtjes do të duhet të rivlerësojnë nevojat, prioritetet dhe procedurat ekzistuese. Një ndryshim i tillë do të ketë pasojat e tij në parashikimet buxhetore të strukturave shtetërore, agjencive të OKB-së dhe OJQ-ve të përfshira.

Qeveria shqiptare, së bashku me UNHCR-në, ka hartuar një raport të veçantë studimor në lidhje me përputhshmërinë e ligjit në fuqi “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit “Për të huajt” dhe zbatimin nga ana e Republikës së Shqipërisë të detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë, si ndaj akteve juridike të organizatave dhe të traktateve ndërkombëtare, po ashtu dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e azilit.

Analiza e mangësive ligjore paraqitet në aneksin që i bashkëlidhet këtij relacioni, si dokumentacion shoqëruar.

Mbetet me rëndësi fakti që kuadri ligjor mbi migracionin në Shqipëri është përditësuar dhe përmirësuar me qëllim parësor respektimin e të drejtave dhe të lirive të migrantëve, qofshin të rregullt apo të parregullt. Ndërkohë, zbatimin e këtij kuadri mbetet akoma problematik pasi ka mangësi, sa i përket institucioneve dhe mekanizmave të nevojshëm për zbatimin plotë të tyre, që duhen ngritur në vazhdimësi apo përmirësuar ato që janë sot.

Të drejtat e të huajve në legjislacionin shqiptar, së pari janë sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 16 të saj, ajo parashikon se:

“Të drejtat e liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.”.

Për më tepër, sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2018, mbi Kapitullin 24, “Drejtësia, Liri dhe Siguria”, thuhet se: “Shqipëria është anëtare e Konventës së Gjenevës së 1961 dhe në 2014 miratoi ligjin e ri për azilin, i cili harmonizon kuadrin ligjor shqiptar me *acquis* të BE-së. Gjithsesi, duke qenë që disa direktiva të BE-së janë përditësuar së fundmi disa çështje kanë përsëri nevojë të adresohen, siç janë ato që lidhen më procedurat dhe garancitë. Veçanërisht, Shqipërisë i duhet t’u sigurojë azilkërkuesve të drejtën e asistencës së rregull dhe shtetasit nga vendet e treta duhet të informohen mbi të drejtat e tyre dhe procedurat e azilit.”. dhe “Udhëzimet që rregullojnë procesin e *presecreening*, dënimin, kthimin apo ripranimin duhen riparë që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Versioni i riparë duhet, gjithashtu, të përfshijë procedurat e masat mbrojtëse për të gjitha kategoritë e personave vulnerabël. Këto rregulla duhet të përputhen dhe me përmbajtjen e ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijës dhe të përshtatet në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë me parimin e moskthimit dhe me të drejtën për gjuhën.”. Ndër të tjera, raporti thekson se: “Kuatru ligjor është përgjithsisht në linjë me *acquis*” dhe se: “Shqipëria është e përgatitur në një farë niveli për zbatimin e *acquis* dhe standardeve europiane në këtë fushë.”. Raporti e vlerëson si një zhvillim pozitiv me një farë progresi përmirësimin e “kapaciteteve institucionale në menaxhimin e kufijve, azilin dhe luftën kundër terrorizimit dhe dhunës ekstreme. Aftësia pritëse për valët e migrimit të kombinuar është rritur. “Raporti i fundit i KE-së, ai i vitit 2018 vendos, ndër të tjera, dhe një afat për shtetin shqiptar për realizimin e strategjisë, teksa thekson nevojën dhe rëndësinë që ajo ka: “Qeverisë i mungon një strategji e plotë dhe gjithëpërfshirëse për migracionin. Strategjitë kombëtare, ajo për migracionin dhe ajo për riintegrimin e qytetarëve shqiptarë të kthyer kanë përfunduar respektivisht në vitin 2010 dhe 2015.”.

Legjislacioni ndërkombëtar mbi migrimin dhe azilin përbën në ditët tona një nga fushat më të zhvilluara të së drejtës ndërkombëtare. Kjo ka ardhur si rezultat i pranimit të fenomenit të migrimit si një fenomen i pashmangshëm, që ndodh për arsye nga më të ndryshmet por mbetet, gjithsesi, tipar i sjelljes njerëzore.

Rregullimi ndërkombëtar i procesit të migrimit ka nisur me traktate e marrëveshje dypalëshe ndërmjet shteteve, për të arritur sot në një tërësi konventash ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë është e detyruar t’i zbatojë.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është në mbështetje të neneve 16, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË**

Ky projektligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2013/33/BE, e Këshillit Evropian dhe Parlamentit, datë 26 qershor 2013, “Për vendosjen e standardeve të pranimit të kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare”;
- Direktivën 2013/32/BE, e Këshillit Evropian dhe Parlamentit, datë 26 qershor 2013, “Mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe heqjen e mbrojtjes ndërkombëtare”;
- Direktivën 2011/95/BE, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Mbi standardet për cilësimin e shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare për një status uniform për refugjatët apo për persona të pranushëm për mbrojtje plotësuese si dhe për Përbajtjen e Mbrojtjes së dhënë”;
- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”.
- Direktivë e Këshillit 2001/55/KE, datë 20 korrik 2001, “Mbi standardet minimale për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rastet e flukseve masive të personave të shpërngulur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh ndërmjet shteteve anëtare në pritjen e këtyre personave dhe përbalimin e pasojave”.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PROJEKTAKTIT**

Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” është i përbërë nga 102 nene dhe është ndarë në 14 krerë.

Kreu I përmban dispozita të përgjithshme ku është parashikuar qëllimi i projektligjit dhe fusha e zbatimit të tij.

Ky projektligj zbatohet për të gjithë shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët kanë deklaruar qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, për aq kohë sa atyre u

lejohe të qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për anëtarët e familjes së tyre.

Përkufizimet e këtij projektligji janë në përputhje të plotë me konceptet/termat kryesorë që janë përkufizuar në direktivat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, në fushën e azilit.

Në këtë kre janë përcaktuar autoritetet përgjegjëse që janë ngarkuar me përgjegjësi për zbatimin e dispozitave të caktuara të këtij projektligji. Gjithashtu, janë parashikuar në mënyrë të plotë dhe shteruese konceptet e vendit të parë të azilit, shtetit të tretë të sigurt, shtetit të sigurt të origjinës, si dhe është rishikuar dhe plotësuar roli i UNHCR-së, në krahasim me parashikimin ligjor ekzistues.

Kreu II përmban parimet bazë dhe garancitë.

Parimi kryesor është parimi i moskthimit *non-refoulement*, në bazë të të cilit Republika e Shqipërisë nuk duhet ta dëbojë ose ta kthejë kërkuesin për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatin, personin nën mbrojtje plotësuese apo personin nën mbrojtje të përkohshme në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve ku i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.

Ndërkohë, përcaktimi i mësipërm nuk mund të zbatohet për një kërkues për mbrojtje ndërkombëtare, person nën mbrojtje plotësuese apo person nën mbrojtje të përkohshme, për të cilin ka arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë apo duke qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Në çdo rast, ky person nuk do të kthehet, të dëbohet ose të ekstradohet për shkaqe që rrjedhin nga e drejta për jetën, si dhe ndalimi i torturës, trajtimi çnjerëzor, degradues, poshtërues ose ndëshkimi.

Në ndryshim nga legjislacioni aktual për azilin dhe në përputhje të plotë me Direktivën Evropiane përkatëse është përcaktuar shprehimisht në projektligj kuptimi i persekutimit, si dhe janë përcaktuar aktorët e persekutimit. Për t'u konsideruar persekutim në kuptim të nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës, akti duhet:

- të jetë mjaftueshëm serioz nga natyra e tij ose përsëritja për të qenë shkelje e rëndë e të drejtave bazë të njeriut;
- në veçanti të lidhet me të drejta për të cilat nuk mund të bëhet derogim sipas nenit 15(2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; ose
- të jetë përmbledhëse e masave të ndryshme, përfshirë edhe shkeljen e të drejtave të njeriut, e cila është mjaftueshëm e rëndë për një individ.



Persekutimi ka formën e:

- aktit të dhunës fizike ose mendore, përfshirë edhe aktet e dhunës seksuale;
- akteve ligjore, administrative, të policisë dhe/ose akte gjyqësore të cilat janë diskriminuese ose janë zbatuar në mënyrë diskriminuese;
- ndjekjes penale ose dënimi penal që është joproporcional ose diskriminues;
- mohimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për rishikim të tyre dhe që rezulton në dënim joproporcional ose diskriminues;
- ndjekjes penale ose dënimit penal për shkak të refuzimit për të kryer shërbimin ushtarak në një konflikt, kur kryeja e shërbimit ushtarak përfshin krime ose akte që janë brenda fushës së veprimit për përjashtim nga e drejta e azilit.
- akteve të kryera në mënyrë të veçantë të lidhura me gratë ose me fëmijët.

Në projektligj është parashikuar vlerësimi i arsyeve të persekutimit, ku mbahen parasysh faktorë të tillë si: raca, besimi, kombësia, përkatësia në një grup të caktuar shoqëror, si dhe bindjet politike të personit që paraqet kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Aktorët që mund të shkaktojnë persekutimin e kërkuesit dhe që fillojnë me organet shtetërore deri në aktorët joshetërorë në një vend të caktuar, që kontrollojnë shtetin ose pjesë thelbësore të atij shteti. Ky nen përcakton edhe faktin e mbrojtjes nga persekutimi, sipas të cilit aktorët duhet të mbrojnë nga persekutimi ose cenimi serioz duhet të sigurojnë mbrojtje efektive dhe jo me natyrë të përkohshme. Frika e bazuar për persekutim apo rreziku real i cenimit serioz mund të bazohet në ngjarje, të cilat kanë ndodhur që nga koha kur kërkuesi për mbrojtje ndërkombëtare ka lënë vendin e origjinës. Frika e bazuar për persekutim apo rreziku real i cenimit serioz mund të bazohet në aktivitete, në të cilat kërkuesi ishte angazhuar që nga koha e lënies të vendit të origjinës, në veçanti kur konstatohet se këto aktivitete paraqesin shprehje dhe vazhdimësi të bindjeve apo orientimeve që mbizotëronin në vendin e origjinës.

Gjithashtu, në këtë kre parashikohet njohja e statusit të refugjatit dhe rastet e përjashtimit nga ky status, dhënia e statusit të mbrojtjes plotësuese dhe përjashtimi nga ky status, e drejta për ndihmë ligjore të garantuar nga shteti për kërkuesin, gjuha e procedurës dhe e drejta për përkthyes, interesi më i lartë i fëmijës, i cili duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë zbatimit të këtij projektligji, si dhe e drejta e informimit dhe e këshillimit që në momentin e hyrjes në pikat e kalimit kufitar apo në qendrat e pritjes për azil.

Në kreun III parashikohen procedurat për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nga struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët që trajton çështjet e azilit në Ministrinë e Brendshme. Shprehja e qëllimit për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare bëhet verbalisht ose në formë të shkruar, në momentin e hyrjes në territorin e Republikën e Shqipërisë, në një pikë të kalimit kufitar, në një stacion të Policisë së Shtetit, si dhe pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin.

Në momentin që i huaji shpreh qëllimin për të paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare dhe plotëson formularin e përzgjedhjes në kufi, i huaji konsiderohet kërkuar për mbrojtje ndërkombëtare, sipas përkufizimit të bërë në këtë projektligj.

Kërkuar mund të kërkojë mbrojtje ndërkombëtare në një gjuhë të cilën ai e kupton dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, informohet për procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes, të drejtat dhe detyrimet në një procedurë të tillë, kushtet e pritjes, të drejtën për të kontaktuar me përfaqësues të UNHCR-së në çdo fazë të procedurës, pasojat e mundshme në rast të mospërbushjes së detyrimeve dhe mosbashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse, si dhe të drejtën për ndihmë ligjore. Ky informacion i vihet në dispozicion kërkuar në mënyrë verbale dhe nëse kërkohej edhe në formë të shkruar.

Përfaqësuesi i kërkuar dhe përfaqësuesi i zyrës së UNHCR-së kanë të drejtë të kontaktojnë atë personalisht në çdo kohë dhe në çdo fazë të procedurës për përcaktimin e mbrojtjes ndërkombëtare.

Në krahasim me ligjin ekzistues janë parashikuar qartësisht afatet për shqyrtimin e kërkesës nga struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët që, si rregull, zgjasin 6 (gjashtë) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, rastet e zgjatjes së afatit të cilat bëhen për një periudhë shtesë prej 3 (tre) muajsh, si dhe është përcaktuar afati maksimal kohor për përfundimin e shqyrtimit të kërkesës që është 21 (njëzet e një) muaj nga paraqitja e tij.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës mund të jenë të pranishëm vetëm personat e mëposhtëm:

- a) Përfaqësuesi i autorizuar;
- b) Kujdestari ligjor i një fëmije të pashoqëruar apo të rrituri me aftësi të kufizuara;
- c) Përkthyesi;
- ç) Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur nuk është caktuar një

- kujdestar për të fëmijën e pashoqëruar;
- d) Përfaqësuesi i UNHCR-së, kur aprovohet nga kërkuesi.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës zhvillohet intervistë personale për çdo kërkesë të paraqitur, e cila mund të regjistrohet dhe procesverbali i transkriptuar shërben si provë në të gjitha fazat e ankimit. Ky procesverbal nënshkruhet nga kërkuesi për të konfirmuar vërtetësinë e tij, pasi i është komunikuar më parë përmbajtja e tij në gjuhën që ai kupton. Nëse kërkuesi refuzon të nënshkruajë procesverbalin, arsyet për këtë refuzim pasqyrohen në dosjen e kërkuesit. Refuzimi për të nënshkruar procesverbalin nuk ndikon në marrjen e vendimit nga struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët.

Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët garanton që intervistat personale të kryhen në kushte të cilat i lejojnë kërkuesit t'i paraqesë arsyet për kërkesën e bërë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Për këtë qëllim, kjo strukturë përgjegjëse merr të gjitha masat për t'i siguruar kërkuesit disa garanci procedurale si p.sh. të intervistohet nga një punonjës i trajnuar, apo i së njëjtës gjini kur kërkohet prej tij, t'i jepet mundësia për të zgjedhur një përkthyes në një gjuhë që ai e kupton, të sigurohet që nëpunësi që kryen intervistën nuk mban uniformë ushtarake, si dhe të sigurohet që intervista me fëmijë të kryhet në mënyrë të përshtatshme për fëmijët. Procedura e shqyrtimi të kërkesës nuk është e hapur për publikun dhe, në veçanti, gjatë intervistës garantohej konfidencialiteti.

Në rastet kur gjatë intervistimit konstatohen dëshmi kontradiktore apo kur struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët e vlerëson të nevojshme për një shqyrtim të gjithanshëm të rrethanave, për të cilat kërkuesi ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, struktura përgjegjëse mund të vendosë të kryejë intervista të tjera me kërkuesin.

Procedura e shqyrtimit të mbrojtjes ndërkombëtare fillon në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë strukturave përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët nga kërkuesi. Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, gjatë shqyrtimit të kërkesës vlerëson nëse kërkuesi kualifikohet si refugjat, apo plotëson kushtet për statusin e mbrojtjes plotësuese, dhe i mundëson kërkuesit të paraqesë, të shpjegojë dhe të dëshmojë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me kërkesën e tij, si dhe të gjitha dokumentet e nevojshme që ndihmojnë në përcaktimin e mbrojtjes ndërkombëtare. Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, gjatë shqyrtimit të kërkesës, merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që ndihmojnë në marrjen e vendimit dhe, për këtë qëllim, bashkëpunon me organizmat ndërkombëtarë si: EASO, UNHCR etj.

Në këtë kre është parashikuar edhe ndërprerja e procedurës së shqyrtimit dhe rastet kur mund të merret një vendim i tillë. Duke qenë se ndërprerja e procedurës është një vendim i ndërmjetëm dhe jopërfundimtar, kërkuesi mund të kërkojë që të rihapet procedura për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare. Kërkesa për ta rihapur procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes pengon dëbimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për rihapjen e procedurës mund të bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 9 (nëntë) muaj nga data kur është marrë vendimi përfundimtar ose i formës së prerë për ndërprerjen e procedurës së përcaktimit të statusit të mbrojtjes.

Gjithashtu, në këtë kre janë përcaktuar elementet e vendimit të strukturave përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, mënyra se si do të merret ky vendim dhe komunikimi i tij, gjatë procedurës së rregullt të shqyrtimit të një kërkesës.

Në krahasim me ligjin në fuqi, struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët mund të marrë vendim për zbatimin e procedurës së përshtetshme, në përputhje me parimet dhe garancitë themelore të përcaktuara në këtë projektligj, lidhur me rastet kur:

- vendimi pozitiv është i bazuar në dëshmitë në dispozicion;
- vendimi është negativ, në rastet e kërkesave të papranueshme apo kur kërkesa është dukshëm e pabazuar.

Gjatë kësaj procedure është parashikuar dhe e drejta e ankimit. Gjithashtu, janë parashikuar rastet e refuzimit të kërkesës dhe paraqitja e një kërkesë të re për mbrojtje ndërkombëtare, e cila mund të paraqitet nga i huaji, kërkesa e të cilit është refuzuar me vendim përfundimtar, që ka marrë formë të prerë dhe shqyrtohet vetëm nëse kërkuesi paraqet fakte dhe të dhëna të reja lidhur me konstatimin nëse ai ka mundësi të kualifikohet për mbrojtje ndërkombëtare.

Në kreun IV përcaktohen rastet e pushimit, të shfuqizimit dhe të humbjes të së drejtës së azilit, ku janë parashikuar rastet e humbjes së statusit të refugjatit, shfuqizimi dhe pushimi i këtij statusi, si dhe rastet e shfuqizimit të statusit të mbrojtjes plotësuese.

Në kreun V janë parashikuar dispozitat mbi qëndrimin e kërkuesit në Republikën e Shqipërisë, ku parashikohen dispozita specifike që nga momenti i pranimit dhe akomodimit të tij në qendrat e pritjes për azil, organizimi dhe funksionimi i saj, liria e lëvizjes së kërkuesve gjatë qëndrimit të tyre, si dhe janë parashikuar rastet dhe masat që merren kur kufizohet liria e lëvizjes, si dhe vizitat mjekësore të cilave mund t'i nënshtrohen kërkuesit që nga momenti që akomodohen në qendër. Kërkuesit mund të vendosen në Qendrën e Pritjes për

Azil, në vendin e përcaktuar nga ministria apo në një vend tjetër sipas dëshirës së tyre. Në rast të vendosjes së kërkuesit në një vend sipas zgjedhjes së tij, shpenzimet e strehimit dhe të jetesës mbulohen nga vetë kërkuesi, si dhe ai ka detyrimin të njoftojë strukturën përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët mbi adresën e re të banimit.

Gjithashtu, janë parashikuar dhe rastet kur mund të bëhet ndalimi apo arrestimi i kërkuesve, si masa shtrënguese që merren në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin penal dhe procedural në fuqi, si dhe largimi i kërkuesit nga territori i Republikës së Shqipërisë, kur u është refuzuar, nuk është pranuar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare apo i është shfuqizuar vendimi i statusit të refugjatit apo i mbrojtjes plotësuese, sipas përcaktimeve në ligjin për të huajt. Në këtë rast struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët njofton autoritetin përgjegjës për kufirin dhe migracionin për zbatimin e legjislacionit për të huajt.

Në kreun VI janë përcaktuar për herë të parë kategoritë e veçanta të kërkuesve, duke parashikuar procedura të veçanta dhe garancitë e nevojshme për pranimin e tyre. Personat që i përkasin kategorisë së veçantë janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prindër të vetëm me fëmijë të mitur, viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, persona me sëmundje të rënda, persona me probleme të shëndetit mendor, ose persona të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale.

Kërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese apo personat nën mbrojtje të përkohshme, që i përkasin kategorisë së veçantë përfitojnë trajtim të ndryshëm në përputhje me nevojat e tyre specifike për akomodimin, ofrimin e kushteve të veçanta të pranimit, trajtimin e nevojshëm mjekësor, si dhe këshillimin e nevojshëm psikosocial. Nëpërmjet procedurave të veçanta dhe garancive të pranimit, i jepet mbështetja e duhur kërkuesve, duke u bazuar në rrethanat e tyre personale të tilla si: moshë, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësi të kufizuara, sëmundje serioze, çrregullim mendor ose si rezultat i torturës, përdhunimit apo formave të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, në mënyrë që të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

Në këtë kre, rëndësi maksimale i është kushtuar fëmijëve të pashoqëruar, të cilët merren në mbrojtje dhe u caktohet një kujdestar, në momentin që shprehin qëllimin për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Për këtë qëllim njoftohet menjëherë struktura e shërbimeve shoqërore në bashki nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki apo njësi administrative, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës së

shërbimeve shoqërore në bashki, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, së bashku me kërkesën për kujdestari.

Janë parashikuar edhe rastet kur fëmijët e pashoqëruar i nënshtrohen vizitave mjekësore për të përcaktuar moshën e tyre, brenda kuadrit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, në rastet kur, pas deklarimeve të përgjithshme apo indicieve të tjera të dobishme, struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët ka dyshime lidhur me moshën e kërkuesit si dhe trajtimi i veçantë i tyre gjatë procedurës së intervistimit.

Në kreun VII janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare. Kërkuesi, deri në përfundimin e procedurave për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, ka të drejtë:

- a) të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë;
- b) të përfitojë kushtet minimale të jetesës;
- c) të ketë kujdesin shëndetësor;
- ç) të përfitojë shërbimet e kujdesit shoqëror;
- d) të përfitojë ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- dh) për arsimim për kërkuesit fëmijë;
- e) të ushtrojë të drejtën e mendimit dhe të besimit fetar;
- ë) për punësim dhe për trajnime profesionale.

Kërkuesi është i detyruar:

- a) të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, si dhe me udhëzimet e dhëna apo masat e ndërmarra nga autoritetet përgjegjëse, sipas këtij ligji;
- b) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe me autoritetet e tjera shtetërore ligjzbatuese;
- c) t'i përgjigjet ftesave të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe/ose organeve të tjera shtetërore përgjegjëse, si dhe të bashkëpunojë në çdo fazë të procedurës;
- ç) të dorëzojë dokumentet e udhëtimit, dokumentet e identitetit dhe/ose prova të tjera që ka në dispozicion;
- d) të njoftojë strukturën përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët për çdo ndryshim të adresës së banimit, brenda 3 (tre) ditësh;
- dh) të veprojë në përputhje me urdhrat e strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, si dhe të gjitha urdhrat e

- autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse, lidhur me kufizimet e lëvizjes;
- e) të mos largohet nga Qendra e Pritjes për Azil apo nga vendi i caktuar nga ministria pa lejen e strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, derisa të përfundojë procedura e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare;
- ë) të bashkëpunojë për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve dhe të fotografisë, për kontrollin fizik dhe të bagazheve, si dhe të sigurojë të dhëna për të ardhurat apo pasuritë që disponon;
- f) t'i nënshtrohet ekzaminimit apo trajtimit mjekësor, me kërkesën e autoritetit përgjegjës në fushën e kujdesit shëndetësor, në rast rreziku të shëndetit publik.

Në kreun VIII janë përcaktuar të drejtat e refugjatit dhe të personit me status të mbrojtjes plotësuese, konkretisht të drejtën për:

- a) shërbime të kujdesit shoqëror, në kushte të njëjta me shtetasit e Republikës së Shqipërisë;
- b) kujdes shëndetësor në kushte të njëjta me shtetasit e Republikës së Shqipërisë;
- ç) të drejtën për strehim të përshtatshëm;
- d) arsim fillor, të mesëm dhe arsimin e lartë në kushte të njëjta me shtetasit e Republikës së Shqipërisë.
- c) integrim në shoqëri;
- dh) ushtrimin e mendimit e të besimit fetar dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi;
- d) punësim dhe për trajnime profesionale;
- ë) bashkimin familjar, sipas përcaktimeve të kreut VIII, të këtij ligji;
- e) përfitim të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
- f) të poseduar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Personi me status refugjati ose personi me status të mbrojtjes plotësuese është i detyruar:

- a) të respektojë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë;
- b) ta njoftojë strukturën përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët për ndryshimin e adresës jo më vonë se 3 (tri) ditë nga ndryshimi i saj.

Në kreun IX janë përcaktuar dispozitat e bashkimit familjar të refugjatit dhe personit me status të mbrojtjes plotësuese, në bazë të së cilave kërkesa për bashkim familjar pranë strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët mund të paraqitet vetëm nga refugjati dhe personi me status të mbrojtjes plotësuese. Është parashikuar procedura e shqyrtimit nga

struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, afatet dhe e drejta e ankimit në rastet e refuzimit të kërkesës për bashkim familjar.

Në kreun X parashikohet procedura e ankimit administrativ në rastet ekërkesëeve për mbrojtje ndërkombëtare. Kërkuesi, personi me status refugjati, personi nën mbrojtje plotësuese ose personi nën mbrojtje të përkohshme ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Kundër vendimit të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e vendimit. Ankimi në gjykatën administrative sipas këtij paragrafi pezullon ekzekutimin e vendimit të Komisionit. Afati për paraqitjen e ankimit në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët kundër vendimit administrativ të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me këtë ligj.

Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është organi administrativ epror që shqyrton ankimet e bëra ndaj vendimeve administrative të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit emërohen në detyrë për një afat katërvjeçar, me të drejtë riemërimi. Anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në kreun XI janë parashikuar dispozita për mbrojtjen e përkohshme, kushtet për dhënien e saj si dhe të drejtat dhe detyrimet e personave nën mbrojtje të përkohshme. I huaji, i cili gëzon mbrojtje të përkohshme, mund të paraqesë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, në çdo kohë. Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare duhet të fillojë vetëm pas përfundimit të mbrojtjes së përkohshme.

Mbrojtja e përkohshme jepet me vendim të Këshillit të Ministrave, për një afat 1 (një)-vjeçar kur ekzistojnë kushtet e përcaktuara. Para afatit të përfundimit të mbrojtjes së përkohshme, Këshilli i Ministrave rivlerëson ekzistencën e kushteve dhe të rrethanave, në bazë të të cilave është dhënë mbrojtja e përkohshme dhe në varësi të rivlerësimit, vendos zgjatjen e afatit ose pushimin e mbrojtjes së përkohshme.

Në këtë kre janë parashikuar rastet e përjashtimit nga mbrojtja e përkohshme, si



dhe përfundimi i kësaj mbrojtjeje. Dispozitat mbi kthimin e personave janë më të detajuara, duke përcaktuar masat që duhet të marrin autoritetet përgjegjëse, si dhe detyrimin e tyre për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut gjatë procedurës së kthimit vullnetar apo dëbimit.

Personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë:

- a) të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas kohëzgjatjes së mbrojtjes së përkohshme;
- b) të kenë kushtet themelore të jetesës dhe të strehimit, në përputhje me mundësitë ekonomike të Republikës së Shqipërisë;
- c) të përfitojnë kujdes shëndetësor;
- ç) të përfitojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti;
- d) për arsim fillor dhe të mesëm në të njëjtat kushte me shtetasit e Republikës së Shqipërisë;
- dh) të drejtën e ushtrimit të mendimit dhe besimit fetar dhe lirinë e fesë sipas bindjeve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fuqi;
- e) për punë.

Në kreun XII janë përcaktuar dokumentet me të cilat pajiset kërkuesi, refugjati dhe personat me mbrojtje plotësuese dhe të përkohshme.

Në kreun XIII janë përcaktuar dispozitat për trajtimin e të dhënave personale. Sipas këtij kreu, struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, për qëllime të zbatimit të këtij projektligji, mbledh dhe përpunon të dhënat personale të kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, apo mbrojtje të përkohshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët nuk duhet të përhapë informacion tek aktorët e pohuar të persekutimit ndaj kërkuesit në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare, ose për faktin që një kërkesë e tillë është paraqitur dhe çdo informacion tjetër që do të rrezikonte integritetin fizik të kërkuesit, anëtarëve të familjes së tij ose lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të tjerë familjes, të cilët ende jetojnë në shtetin e origjinës. Për çdo kërkues, struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët administron gjurmët e gishtave dhe fotografinë e secilit prej tyre. Përjashtim nga ky rregull bëjnë fëmijët nën moshën 12 vjeç. Gjurmët e gishtave dhe fotografia regjistrohen nga Policia e Shtetit në bazën e të dhënave. Në bazë të përcaktimeve të këtij kreu ndalohet transferimi jashtë vendit, i të dhënave personale të mbledhura për kërkuesin pa konfirmimin me shkrim të strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët. Të dhënat personale të marra sipas këtij projektligji asgjësohen ose shkatërrohen në përputhje me procedurën dhe afatin e përcaktuar nga

legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët administron dhe mirëmban regjistrin e të dhënave për regjistrimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare dhe mbrojtje të përkohshme, të cilat paraqiten dhe trajtohen në përputhje me këtë projektligj, vendimet e marra nga autoritetet përgjegjëse, si dhe çdo e dhënë tjetër e nevojshme që përcaktohet nga ministri. Përmbajtja dhe mënyra e administrimit të këtij regjistri përcaktohen me urdhër të ministrit.

Në kreun XIV janë përcaktuar dispozitat e fundit ku parashikohet detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji, nxjerrja e akteve nënligjore, dispozita kalimtare në lidhje me trajtimin e kërkesave të depozituara në bazë të ligjit nr.121/2014 dhe të pashqyrtuara deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij projektligji, si dhe vlefshmëria e dokumenteve të lëshuara, dispozita e shfuqizimit dhe e hyrjes në fuqi të projektligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Brendshme (Struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Brendshme me asistencën e UNHCR-së. Projektligji i është nënshtruar një diskutimi dhe konsultimi të gjerë, brenda vendit, si dhe jashtë vendit me organizata ndërkombëtare të OKB-së dhe organizma të specializuar të Bashkimit Evropian.

Për diskutimin e tij është organizuar edhe një tryezë konsultimi me të gjitha palët e interesuara, në të cilën janë tërhequr mendimet dhe opinionet e institucioneve shtetërore që merren me të drejtat e njeriut dhe organizatave jofitimprurëse që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre të drejtat e njeriut dhe çështjet e azilit në veçanti.

Gjithashtu, projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i këtij projektligji shoqërohet me efekte financiare në lidhje me shtimin e burimeve njerëzore pranë struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët, që trajton çështjet e azilit në Ministrinë e Brendshme, ku janë planifikuar të shtohen 2 (dy) specialistë, të cilët do të sigurojnë:

- kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët dhe strukturave homologe për mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit për vendet e origjinës;
- shkëmbim të informacionit aktualisht me vendet anëtare të MARRI-t dhe në të ardhmen me shtetet anëtare të BE-së mbi gjenealitetet e azilkërkuesve/kërkuesve në përputhje me EURODAC.

Efekti financiar vjetor për 2 (dy) specialistët është në total 2 297 000 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë, nga të cilat efekti financiar për paga për 12 muaj është 1 968 000 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, ndërsa efekti financiar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për 12 muaj është 329 000 (treqind e njëzet e nëntë mijë) lekë. Për vitin 2020 efekti financiar do të jetë për 6-mujorin e dytë të këtij viti, nëse do të miratohet shtesa në burime njerëzore e sektorit të azilit, pjesë e strukturës së Ministrisë së Brendshme.

Gjithashtu, ngritja e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët do të shoqërohet me efekte financiare në lidhje me shpërblimet e parashikuara për pesë anëtarët e tij. Efekti financiar për ngritjen e Komisionit do të detajohet dhe përcaktohet në projektvendimin e Këshillit të Ministrave që do të propozohet për këtë qëllim brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij projektligji.

### **KËSHILLI I MINISTRAVE**